



KOMUNIKATË

21.12.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur sot shqyrtoi vendimin e KZAP-it lidhur me Raundin e Dytë të Zgjedhjeve. KZAP ka udhëzuar KQZ-në me vendimin A nr. 508/ 2009, që të urdhëroj ripërsëritjen e votimeve në komunat Lipjan, Prizren dhe Gjilan për Kryetar të Komunave.

Kryetarja e KQZ-së, znj. Nesrin Lushta, kërkoi nga anëtarët e KQZ-së të vendosin për udhëzimin e KZAP-it. Me votim të hapur, anëtarët e KQZ-së me 7 vota për, 2 kundër dhe 2 apstenime vendosën që të kërkojnë informacione (shpjegime) shtesë nga KZAP-i, lidhur me vendimin e dhënë.

Në këtë takim, Kordinatori i Qendres së Numrimit të Rezultateve (QNR), z. Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në lidhur me numërimin e votave me kusht. Z. Ahmetaj, i ka raportuar KQZ-së procedimet e bëra në QNR. Janë numëruar votat për 17 komuna, dhe me këtë dihen edhe fituesit e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.

KQZ e ka urdhëruar QNR-në që të filloj edhe numërimin e votave me kusht, në komunën e Rahovecit.